

	
ODHA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njsela:	Nr. Prot.: 27/2018
Unit:	Prot. No.:
Jednica:	Br. Prot.:
Nr. i faqëve:	Data: 17.05.2018
No. of pages: -02-	Datum:
Br. stranica:	Prilohin/a

REF.NR. 135/2018

KËSHILLI ETIK I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS (OMK), në përbërje prej Dr. Fejsal Mehmeti – Kryetar, Dr. Miftar Zenelaj – zv.Kryetar, Dr. Afrim Muhaxheri – anëtar, Dr. Fakte Hoxha – anëtare dhe Dr. Gylxhan Hasani – anëtar, në çështjen etike NR. 135/2018 të datës 16.03.2018, në procedurën e shqyrtimit fillestar të çështjes, me datë 10.05.2018 nxjerrë këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KTHEHET** për plotësim parashtrësë e Inspektoratit Shëndetësor NR. 135/2018 të datës 16.03.2018 për precizim subjektiv dhe kualifikim të shkeljes etike.
- II. Plotsimi i parashtrësës nga paragrafi I të këtij aktvendimi duhet bërë në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.
- III. Në rast të dështimit të plotsimit të parashtrësës sipas paragrafit II të këtij aktvendimi, do të konsiderohet se parashtrësë është tërhequr.

A r s y e t i m

Me datë 16.03.2018, Këshilli Etik i OMK-së ka pranuar parashtrësën e Inspektoratit Shëndetësor që mbanë numrin e protokollit NR. 135/2018. Me të pranuar parashtrësën e palës së autorizuar, Këshillit Etik me datë 10.05.2018 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar mbi parashtrësën e palës së autorizuar, respektivisht Raportin e inspektimit specifik në Departamenti Nëna dhe Fëmiu në Pejë, Klinikën e Kirurgjisë Abdominale dhe Klinikën e Urologjisë në QKUK. Nga parashtrësë në fjalë, në bazë të shkresave të lëndës, Këshilli Etik ka konstatuar se pala e autorizuar nuk ka bërë cilësimin subjektiv lidhur me ekzistimin e dyshimit të bazuar. Në parashtrësën e palës së autorizuar nuk është specifikuar se ndaj cilit mjek rëndon dyshimi i bazuar, gjë që paraqet kusht paraprak për iniciimin e procedurës etike.

Po ashtu, në shkresat e lëndës dhe parashtrësën e parashtruar nga pala e autorizuar, nuk është bërë kualifikimi i shkeljes etike për të cilën iniciohet procedura. Kualifikimi juridik i shkeljes së supozuar, paraqet element përbërës të ankesave që paraqiten nga institucionet në cilësi të palëve të autorizuar, pasi që në bazë të Nenit 31 paragrafit 4 të Rregullores për Përcaktimin e Llojit të Shkeljeve Etike dhe Procedurat e Mbikëqyrjes Etike dhe Profesionale, ankesat e institucioneve publike procedohen drejtpërdrejt pranë Këshillit Etik dhe ndaj të njëjtave ekziston prezumimi i ekzistimit të dyshimit të bazuar. Ankesat e tilla që parashtrohen nga institucionet publike në cilësi të palëve të autorizuar nuk procedohen pranë Prokurorit të Odës, mirëpo të njëjtat përfaqësohen nga personi i autorizuar i institucionit gjegjës. Konsumimi apo prezumimi i dyshimit të bazuar për ankesat e parashtruar nga institucionet publike sipas dispozitave të Rregullores për Përcaktimin

e Llojit të Shkeljeve Etike dhe Procedurat e Mbikëqyrjes Etike dhe Profesionale, është në arsyen e prezumimit se institucionet publike posedojnë kuadrin profesional për të përmbushur kushtet formale të përmbajtjes së parashtrësave që janë paraparë me Nenin 32 dhe 38 të Rregullores për Përcaktimin e Llojit të Shkeljeve Etike dhe Procedurat e Mbikëqyrjes Etike dhe Profesionale.

Për arsye të tilla, pala e autorizuar udhëzohet që ta bëjë plotësimin e parashtrësës duke specifikuar qartë se ndaj cilit mjek rëndon dyshimi i bazuar, si dhe të bëjë kualifikimin juridik të shkeljes etike sipas Kodit Etik të OMK-së.

Nga të lartcekurat, Këshilli Etik në mbështetje të Nenit 32, paragrafit 3 të Rregullores për Përcaktimin e Llojit të Shkeljeve Etike dhe Procedurat e Mbikëqyrjes Etike dhe Profesionale, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Prishtinë, 17.05.2018

Kryetari i Këshillit Etik
Dr. Fejsal Mehmeti



KËSHILLI ETIK I OMK-SË
NR.REF. 27/2018 DATË 17.05.2018

KËSHILLË JURIDIKE: Ndaj këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.